



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.36, datë 20/07/2005

**“MBI SPOSTIMIN E KUFIRIT TË PRONËS
SË OFIÇINËS SË AUTOMJETEVE TIRANË
PËR SHKAK TË ZGJERIMIT TË RRUGËS “IRFAN TOMINI”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 3/1, gërma “c”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.378, dt.12/08/1999 “Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, pika 2, Vendimit të Këshillit të ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, pika 2, gërma “ç”, Vendimit të K.RR.T-së Nr.87, dt.17/03/2004 “Rehabilitimi i rrugës “Irfan Tomini” segmenti i rrugës së Kavajës deri tek sheshi në kryqëzimin me bulevardin “Bajram Curri”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Kalimin kapital të sipërfaqes së truallit prej 12 m² nga Ofiçina e Automjeteve Tiranë në Ndërmarrjen Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, me qëllim realizimin e projektit për rehabilitimin e Rrugës “Irfan Tomini” dhe prishjen e pjesshme të Zyrës së Rojes Operative.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, Ofiçina e Automjeteve të kryejë veprimet e nevojshme kontabile.
3. Të bëhet azhurnimi i genplanit të ri të Ofiçinës së Automjeteve Tiranë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtorja Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Ofiçina e Automjeteve Tiranë.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI